



ZYRA PARLAMENTARE PËR BUXHET (ZPB) NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

HYRJE NË ZYRAT PARLAMENTARE PËR BUXHET (ZPB)

Deputetët në parlamentet, përveç që përcaktojnë tatimet me anë të cilëve shteti mbledh mjetet financiare nga qytetarët dhe përcaktojnë mënyrën në të cilën ato shpërndahen me anë të miratimit të Buxhetit, kanë edhe obligim që të bëjnë kontroll në mënyrë që pushteti ekzekutiv i shpenzon këto mjete financiare.

Me kalimin e viteve, buxhetet bëhen më të ndërlikuara, përfshijnë shumë aspekte të ekonomisë dhe shoqërisë, dhe me atë edhe kontrolli i tyre u bë më i ndërlikuar. Vëllimi i informacioneve dhe resurseve me të cilat disponon pushteti ekzekutiv krijon një asimetri në informimin e pushtetit ekzekutiv ndaj parlamenteve. Për balancim të kësaj asimetrie formohen zyrat parlamentare për buxhet. Zyrat Parlamentare të Buxhetit kontribuojnë për këtë baraspeshë me anë të sigurimit të informacioneve dhe analizave të paanshme, objektive, të kohëshme, dhe të sakta për deputetët.

Institucioni i parë i formuar i këtij lloji është Zyra Buxhetore e Kongresit në SHBA, e themeluar në vitin 1974. Pastaj vijon formimi i zyrave nëpër parlamentet në vendet tjera: Britani e Madhe, Austri, Skoci, Sllovakia, Serbi dhe tjera.

THEMELIMI I ZPB-SË NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ideja për formimin e ZPB-së në Kuvendin e RMV ishte paraqitur si rezultat i përpjekjeve dhe rekomandimeve të pjesëmarrësve në konferencën e zhvilluar në Villton Park, Britani e Madhe, në shkurt të vitit 2018. Formimi i këtij autoriteti ishte edhe një prej rekomandimeve kryesore nga "Raporti për Vlerësimin e Praktikave për Mbikëqyrje Financiare në Kuvendin e RMV", përgatitur me mbështetjen e Parlamentit të Skocisë.

Duke vepruar sipas këtyre rekomandimeve, në dhjetor të vitit 2018 u nënshkrua memorandum mirëkuptimi mes Kuvendit, Ambasadës së Britanisë dhe Vestminster Fondacionit për Demokraci. U formua Bordi Drejtues që ka marrë pjesë në vizitë pune të zyrave buxhetore të parlamenteve të Skocisë dhe Serbisë. Në shtator të vitit 2019, Bordi Drejtues ka marrë Vendim për Themelimin e Zyrës Parlamentare për Buxhet (ZPB) në kuadër të Shërbimit të Kuvendit.

ÇFARË PARAQET ZYRA PARLAMENTARE PËR BUXHET (ZPB) NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT?

Zyra Parlamentare për Buxhet paraqet një njësi të veçantë organizative – departament në kuadër të Shërbimit të Kuvendit të RMV-së, dhe ky formim u parashikua me Nenin 42-a nga Ligji i Kuvendit i Republikës së Maqedonisë. Sipas ligjit, ZPB-ja është një qendër analize që shërben për avancimin e mbikëqyrjes financiare parlamentare me anë të përgatitjes së analizave eksperte financiare dhe buxhetore për nevojat e deputetëve dhe trupave të punës.

Analizat financiare përfshijnë materiale informative, sesione të shkurta informative dhe studime të shkurta lidhur me: buxhetin, rebalancin dhe llogaritë përfundimtare të buxhetit të RMV-së, raportet vjetore dhe raportet tjera financiare të Entit Shtetëror për Revizion, si dhe trupave tjera të pavarura të themeluar nga Kuvendi i RMV-së. ZPB-ja mundet: të kryejë analiza nga fusha e politikave fiskale dhe monetare, të hartojë kalkulime financiare të propozim-politikave, si dhe vlerësime të shpenzimeve dhe dobive (cost-benefit) të propozim-ligjeve të parashtruara nga deputetët. ZPB-ja e ndjek punën e Komisionit për Financim dhe Buxhet, Këshillin Buxhetor dhe trupave tjerë të punës të Kuvendit dhe harton analiza dhe statistika të pasqyrave makro-ekonomike për nevojat e tyre. ZPB-ja mund të organizojë seminare dhe punëtori nga fusha e politikës fiskale, lidhur me mbikëqyrjen financiare dhe buxhetore të Kuvendit të RMV-së dhe kryen shkëmbim të informacioneve me parlamente tjera, institucione tjera të drejtimit shtetëror dhe institucione ndërkombëtare financiare.

Misioni i ZPB-së është të përforcojë rolin e përcaktuar ligjvënës dhe mbikëqyrës të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë me anë të sigurimit të analizave të kohëshme, të paanshme dhe objektive, dhe të vënë në dispozicion të pushtetit ligjvënës.

ZPB-ja udhëhiqet nga parimet e ekspertizës, objektivitetit, besueshmërisë dhe transparencës.

AKTIVITETET E PARAPARA TË ZYRËS PARLAMENTARE PËR BUXHET – ZPB LIDHUR ME PËRPUNIMIN E ANALIZAVE FINANSIARE DHE SESIONEVE EDUKATIVE

KALENDARI I AKTIVITETEVE TË ZYRËS PARLAMENTARE PËR BUXHET

Periudha e muajit	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor
prej 1 deri 15	Shqyrtim i shkurt i Buxhetit të RMV për vitin fiskal përkatës								Shqyrtim dhe analizë e Rebalancit të Buxhetit të RMV për vitin fiskal përkatës			Udhëzues për Buxhetin e RMV për vitin fiskal përkatës
	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore	Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik – baza mujore
		Shkëmbimi i jashtëm tregtar i RMV						Shkëmbimi i jashtëm tregtar i RMV				
			Tregu i punës TM4			Tregu i punës TM1			Tregu i punës TM2			Tregu i punës TM3
prej 15 deri 30	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale	Tendenca fiskale
						Llogaria përfundimtare e Buxhetit të RMV						
			Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik TM4			Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik TM4			Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik TM4			Pasqyrë statistikore e indikatorëve makroekonomik TM4
					Realizimi sipas përdoruesve të buxhetit				Realizimi sipas përdoruesve të buxhetit			
		Analizë krahasuese e të ardhurave buxhetore me referencë të veçantë në Buxhetin e RMV						Analizë krahasuese e të ardhurave buxhetore me referencë të veçantë në Buxhetin e RMV				
	Tregu i punës në RMV dhe në vendet e rajonit						Tregu i punës në RMV dhe në vendet e rajonit					
					Analiza krahasuese e borxhit publik						Analiza krahasuese e borxhit publik	
		Shkëmbimi i jashtëm tregtar i RMV						Shkëmbimi i jashtëm tregtar i RMV				

Aktivitetet e planifikuara në lidhje me edukimin/seancat për deputetët

- 1 Buxheti dhe Procesi i Buxhetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- 2 Borxhi publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- 3 Politika fiskale dhe monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- 4 Prokurimi Publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- 5 Tregu i punës
- 6 Prezantimi i treguesve bazë makroekonomikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- 7 Tregtia e jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- 8 Do të organizohen seanca shtesë edukative sipas nevojave dhe kërkesave të deputetëve

MBI VESTMINSTER FONDACIONIN PËR DEMOKRACI (WFD)

Vestminster Fondacioni për Demokraci (WFD) është një trup i financuar nga Qeveria e Britanisë së Madhe që ka për qëllim të sigurojë mbështetje gjatë themelimit të demokracisë efektive shumë-partiake në vendet në zhvillim. Nga viti 1992, WFD-ja ofron trajnim, mbështetje teknike dhe mundëson shkëmbim të njohurive mes institucioneve të Britanisë së Madhe dhe vendeve partnere.

Zyra e WFD-së në Shkup është themeluar në vitin 2008 dhe është zyra e parë e formuar jashtë Britanisë së Madhe. ZPB-ja është themeluar me anë të programit Iniciativa për Demokraci në Ballkanin Perëndimor (WBDI), që punon me tetë parlamente, institucione publike, parti politike dhe organizata qytetare nga gjashtë shtete. WBDI-ja punon në përmirësimin e përfaqësimit të grave, të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara në proceset politike, si dhe mbështet edhe partitë politike në demokratizimin e tyre dhe në përmirësimin e politikave.

www.wfd.org/wbdi

[www.fb.com/WBDDemocracy](https://www.facebook.com/WBDDemocracy)

Për më shumë informata rreth ZPB dhe punës së WFD në Maqedoninë e Veriut mund të lajmërohëni në kontaktet në vijim:

Julijana Krstevska – Petrushevska,
Udhëheqëse e Seksionit - Zyrat Parlamentare për Buxhet (ZPB),
julijana.petrushevskapbo@gmail.com

Damir Neziri,
Përfaqësues në vend i WFD,
damir.neziri@wfd.org

Petar Trajkov,
Menaxher programor,
petar.trajkov@wfd.org

